



Republika e Kosovës / Republic of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr 3460 /2023
Data: 20.04.2023

PROCESVERBAL I KOMITETIT PER KOMUNITET

Nga mbledhja e tretë -III- për vitin 2023 i Komitetit për Komunitete, mbajtur me datë: 29.03.2023 me fillim pune në ora 14:00 në sallën e takimeve. Kryesuesi konstatoi se nuk mungon asnjë anëtarë i Komitetit për Komunitete. Prezent ishin : znjsh.**Majlinda Kaloshi** (Drejtoreshë për Zhvillim Ekonomik) z.**Abdurrahman Bushi** (Drejtor për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural).

RENDI I PUNËS

- 1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar
- 2.Takim me Kryesuesin e Këshillit të Prindërve, te Shkollave.
- 2.Takim me Drejtorinë për Zhvillim ekonomi
- 3.Takim me Drejtorinë për bujqësi , Pylltari dhe Zhvillimit Rural.
- 4.Eventuale.

U MIRATUA RENDI I PUNËS

- 1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin; nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

2.Takim me Kryesuesin e Këshillit të Prindërve, te Shkollave.

Kryesuesi thekson:- Pasi që Kryesuesi i Këshillit të Prindërve të Shkollave nuk është prezent kalojmë në pikën e tretë të rendit të punës

2.Takim me Drejtorinë për zhvillim ekonomi

Kryesuesi thekson:- A keni ofruar trajnime për lëmi të ndryshme? Lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin

Majlinda Kaloshi thekson:- Gjatë vitit 2022 kemi filluar një trajnim softuerik dhe harduerike për gjininë femërore. Kemi mbajt edhe takime informuese për gra se si të aplikojnë për grant qeveritar për bizneset e tyre, pas muajit të ramazanit kemi me zhvillu me trajnime të tilla, gjatë javës së kaluar kemi mbajt edhe disa trajnime për të rinjtë për punë praktike ku ministria e financave bashkë me UNICEF është duke i realizuar ne jemi duke i ndihmuar aplikantëve në aplikim.

Kryesuesi thekson :- A i keni përgatit si drejtori Hartimin e planit strategjik të zhvillimit ekonomik.

Majlinda Kaloshi thekson:- Tek Hartimi i planit strategjik kemi pas ekzistuesin ku në dhjetor të vitit të kaluar ka skaduar gjatë muajit shkurt e kemi mbajt punëtorinë e parë që e kemi formuar grupin me vendim të Kryetarit që i kenë përfshirë prej shoqërisë civile OJQ drejtorit dhe jemi duke e hartuar planin .

Zaim Bela thekson:- E përgëzoj drejtoreshën për raportin , kisha një pyetje për pagesat se sa i realizojnë pagesa kompanitë në komunën tonë dhe sa është borxhi total dhe në rast të hapjes së biznesit të ri sa janë të liru nga pagesa.

Majlinda Kaloshi thekson:- Në rast se biznesi është regjistruar në emër të një gruas lirohet prej taksës për ushtrim të veprimtarisë deri në 4 vjet ndërsa për meshkuj është 2 vjet , tek inkasimi nuk kam për momentin raport ndërsa sa ju përket borxheve është e vërtet që ka borxhe jemi duke punuar një plan të veprimit të mënyrës inkasimit të këtyre llogarive të arkëtueshme me qëllim të zbutjes së këtyre borxheve.

Resul Suma thekson:- A ka drejtë komuna ti dërgoj në përmbarues.

Majlinda Kaloshi thekson: Po ka të drejtë , po ne si drejtori bashkë me kryetarin nuk kemi dëshirë që me zhvilluar në atë mënyre kemi filluar me procedura pak më të lehta , kemi shpërnda letër kujtesa gjithashtu na e ofrojmë edhe mundësin e pagesës me këste.

Resul Suma thekson:- është fituar një grant tek ura e Seçishtës kur do të filloj të punohet.

Majlinda Kaloshi thekson:- Kontrata është nënshkruar mbetet vetëm që të fillojnë procedurat.

Kryesuesi thekson : Gjatë procedurave të konkurseve si bëhet shpallja e kriterëve a është me ligj.

Majlinda Kaloshi thekson: Sa i përket drejtorive ato emërohen nga vendimi i kryetarit ndërsa konkurset e tjera bëhen në mënyra ligjore.

3.Takim me Drejtorinë për bujqësi , Pylltari dhe Zhvillimit Rural.

Kryesuesi thekson:- Disa persona po i gëmtojnë disa shtylla të betonit në një arë duhet paralajmëruar sepse po bëjnë dëm në ato vende.

Abdurrahman Bushi thekson:- me ligj 300 metra afër vendbanimeve nuk kanë drejtë armët të jenë të mbushura .

Zaim Bela thekson:- sa fermer kanë aplikuar për subvencione.


Abdurrahman Bushi thekson:- 90 fermer kanë aplikuar deri sot.

4.Eventuale.

Nuk pati diskutime

Mbledhja përfundoj në 14:55

Procesmbajtësja
Sara Berisha



Kryesuesi i Komitetit
Mefail Suma

